



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:249494

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05548080

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit D.. A.. për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II.nr.2391/22 të datës 24.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të mbyllur për publikun, me datë 27.03.2024 në prezencë të Prokurores se Shtetit Lumturie Hoxha , i pandehuri D.. A.., të dëmtuarës A.. B.., të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 04.04.2024 përpilon këtë:

**A K G J Y K I M**

**I pandehuri,**

**D.. A..**, i lindur më ..... në V.. R.. I.., me vendbanim në P.. rr. e B.. O.. I.. H.. 2.., nga babai Q.., dhe nënës Gj.., e vajzërisë S.., shkollim fillor, i martuar, me profesion punëtorë, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitetit B..., shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar me parë, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTORË**

**Për shkak se:**

Ne vazhdimësi e gjer me dt. 10.11.2022, rreth orës 10:50 min, në P.., nuk e përfill urdhrin e Gjykatës Themelore ne Pejë, C.nr../.., te dt. 16.05.2022, me te cilin aktgjykim, caktohet masa mbrojtëse, ku kryesit te dhunës D.. A.., i ndalohet qe palën ne mbrojtur , te dëmtuarën A.. B.., ta shqetësoi, ofendoi apo maltretoi, përul, godas, kërcënoi, sulmoi fizikisht, ndjekë, përcjellë, mbaj nën vëzhgim, bllokoi lëvizjen, por i njëjti nuk e përfill vendimin e lartcekur.

-me çka ka kryer veprë penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 17, 43, 47,48 49, 69, 70, 393 par 1 të KPRK-së dhe neni 364 të KPPRK- së, të pandehurit D.. A.. i shqipton:

### **DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURG**

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, cilin dënim i pandehuri nuk do të ta mbaj në rast se i njëjti në afat prej 1 (një) vite nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej 40,00 € në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

E dëmtuar A.. B.. nga P.. rr. e B.. O.. I.. H.. 2.., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm ka ngrit aktakuzë aktakuzës PP/II.nr.2391/22 të datës 24.11.2022, ndaj të pandehurit D.. A.. për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Pejë me parashtresën e datës 12.12.2022 e ka ndryshuar aktakuzën PP/II.nr.2391/22 të datës 24.11.2022 sa i përket përshkimit faktik dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke e akuzuar te pandehurin D.. A.. për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Pejë me Aktgjykimin P.nr.1011/22 të datës 14.04.2023 të pandehurin e ka shpall fajtor dhe e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pas parashtrimit të ankesës nga ana të pandehurit Gjykata e Apelit me Aktvendimin PA1.nr.721/23 të datës 12.12.2023 e ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate dhe çështjen e ka kthyer ne rivendosje.

Ne rivendosje ne shqyrtimin fillestar të datës 27.03.2024 të mbajtur në prezencë të Prokurores se Shtetit Lumturie Hoxha , i pandehuri D.. A.., të dëmtuarës A.. B.., dhe përkthyesit të gjykatës A.. T.., gjykata ne pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin D.. A.. për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaroi për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorisë gjykata është bindur se i pandehurit e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se jam penduar, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla, me vjen keqe çka ka ndodhë, jetoj ne bashkësi familjare prej 6 anëtar, jam baba i 4 fëmijëve punoj kohë pas kohe ne Austri.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit i cili ka deklaruar se: : pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës. Kryesisht ne mesazhet e te dëmtuarës për mes telefonit andaj gjykatës i propozojte qe ta pranoj fajësinë nga ana e te njëjtit.

E dëmtuar A.. B.. ka deklaruar: se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana te pandehurit dhe i premtoj qe ndaj te njëjtit ti shqiptoj një dënim alternativ ngase prej kohës se kryerjes se kësaj vepre penale me te pandehurin nuk kemi pas asnjë problem, nuk kërkoj kompesim demi dhe nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, te njëjtin e kam bashkëshortë dhe se i kemi rregulluar raportet, jetojmë se bashku, i njëjti kujdeset për familjen.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit fillestar nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 te KPPRK-se, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPRK-se, ngase aktakuza mbështet ne këto prova: raporti i policit S.. H.., i dt. 10.11.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën A.. B.., e dhënë pran stacionit policor ne Pejë, me dt. 10.11.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin D.. A.., i dhënë pran stacionit policor ne Pejë, me dt. 10.11.2022; procesverbali i seancës gjyqësore C.nr../.., i dt.16.05.2022; mesazhet telefonike, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit meqenëse nuk kishte propozime të tjera nga palët në procedurë.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze te se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 393 par 1. të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurën, gjykata mori pranimin e fajësisë, faktin se tani e dëmtuara nuk ka kërkuar kompensim dënim dhe nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale, i pandehuri tani jeton Austri dhe ka filluar marrëdhënie të rregull të punës dhe kujdeset për familje.

Ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes ne kryerjen e veprës penale, vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, me parë ka qenë i dënuar me aktgjykimet e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.704/22 të datës 15.12.2022 i plotfuqishëm për veprën penale dhunë në familje nga neni 248 par. 1 të KPRK-së ndaj të dëmtuarës së njëjtë përkatësisht bashkëshortes së tij A.. B., me aktgjykimin P.nr.378/22 I dates 13.02.2023 për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, duke i tërhequr e vërejtjen me kërcënimin e dënimit mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin që ti paguaj shpenzimet për paushall gjyqësor në shumë prej 20,00 €, e duke u bazuar ne shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj dhe 20,00 € për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit,

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2022:249494, 04.04.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**

Edona Berisha Kastrati

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

jetoj ne bashkësi familjare prej 6 anëtar, jam baba i 4 fëmijëve punoj kohë pas kohe ne Austri.